

“HTS COMPANY” Shpk

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“HTS COMPANY” Shpk.

Sot, me date 09.04.2021, ne nënshkruarit,

Ne baze te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne te nënshkruarit

1. Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues ne Tiranë, i identifikuar me Karten e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me date 26.02.2019 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me cilesine e “ortakut themelues”

ne baze te rregullimeve te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne te nënshkruarit vendosem të themelojme Shoqërinë me Përgjegjësi te Kufizuar te emëruar “HTS COMPANY” Shpk. (me poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjese përbërëse e këtij Akti Themelimi.

Neni 1

FORMIMI I SHOQERISE

**Formohet shoqëria e me pergjegjesi te kufizuar, me emrin
“HTS COMPANY” Shpk.**

me ortake themelues:

1. Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues ne Tiranë, i identifikuar me Karten e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me date 26.02.2019 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me cilesine e “ortakut themelues”

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga “Tish Dahia”, Kika 2, shkalla nr.3, kati 5, apt.22, Tirane.



“HTS COMPANY” Shpk

Adresa e shoqërisë me qellim komunikimin elektronik është: celaskender@gmail.com.

Adresat elektronike të ortakëve do të jenë si më poshtë:
celaskender@gmail.com.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, selia e shoqërisë mund të transferohet në një rajon tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo dhe jashtë tij.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bisnezit.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj do të kryejë:

- Projektim dhe Mbikqyrje-Kolaudim të punimeve të zbatimit, si punime germimi në toke, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion, mirembajtje godinash civile, industriale, veshje fasada, rrugë, autostrada, hekurudha etj.
- NP- I Punime germimi në toke. NP-2 Ndertime civile dhe industriale. NP-3 Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale. NP-5 Punime nëntokesore, ura e vepra arti. NP-6a Diga të çdo lloji madhësie. NP-6b Diga të vogla (diga me lartësi deri 10 m ose me vëllim uji të grumbulluar deri 1 milion m³ ose gjatësi kurore dige deri 500 m). NP-6c Tunele hidroteknike. NP-7a Ujësjetes, kanalizime, vepra kullimi e vaditje. NP-7b Vepra naftësjetes-gazsjelles-vajsjelles. NP-8 Ndertime detare dhe punime thellimi në ujë. NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime. NP-10 Ndertimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike. NP- 11 Ndertime për nënstacionet, kabinetat e transformatoreve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS-1 Punime për prishjen e ndertimeve. NS-2 Impiante hidro-termosantare dhe mirembajtja e tyre. NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensore, shkallë, levizëse, transportues). NS- 4 Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. NS-5 Impiante të sinjalistikës ndërtuese të trafikut. NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndërtuese. NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore. NS-8a Ndertime parafabrikat beton arme. NS-8b Struktura metalike NS-8c Struktura druri. NS-9 Punime strukturore speciale. NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale. NS-11 Punime mbi shina dhe traversa. NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. NS-15 Pastrimi i ujerave detare, liqenore dhe lumore. NS-16 Ndertimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. NS- 17



"HTS COMPANY" Shpk

Ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. NS-18 Punime topogjeodezike. NS-19 Sistemet kundra zhurmes per infrastruk-ture. NS-20 Shpime gjeologoinxhinierike, puse e shpime per uje. NS-21 Impiante te trajtimit te ujerave te zeza.

- Kat.1 Projektim Urbanist, Kat.2 Projektim Arkitekt, Kat.3 Projektues Konstruktore Kat.4 Projektues Instalator, Kat.5 Projektues vepra hidraulike Kat.6 Projektues rruge-hekurudha, Kat.7 Projektim ura dhe vepra arti, Kat.8 Projektues gjeodet, Kat.9 Studim gjeologoinxhinierik-hidrogjeologjik, Kat.10 projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjiise elektrike, Kat.11 Projektim te sinjalizimit rrugor, Kat.12 Studime te sizmologjiise inxhinierike, Kat.13 Studime e projektme te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta urbane, Kat. 14 Studime e projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza.
- Hartim projekti dhe mbikqyrje punimesh per resataurimin e objekteve qe jane monument kulture si dhe Mbikqyrje te mirembajtjes.
- Auditim mjedisor dhe ekspertize ne vleresimin e ndikimit ne mjedis ne te gjitha fushat e ndertimit dhe teknologjite me ndikim ne mjedis. Ndertime turistike, bujqesore, etj dhe kompletim me instalimet e nevojshme.
- Ekspert privat zjarrfikes.
- Konsulence teknike, sherbime, projektim e zbatim, revizion dhe tregtim ne fushat punime topogjeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, rivlime topografike, punime topogjeodezike, sistemet e informacioneve gjeografike. Vlersim Pasurie per Toke dhe Ndertesa. Akte Ekspertimi per Gjykate.
- Punime per gjelberim, mbareshtim pyjesh, kryerjen e sherbimit per sperkatjen me herbicide kunder semundjeve te ndryshme, mbrojtjen e druve frutor nga parazitet dhe mbrojtja e bimesise me metoda biologjike.
- Master plane studime plane rajonale urbanistike, plan rregullus te pergjithshem per qendera te banuara dhe qytete.
- Mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve te ndertimit, etj. grumbullim dhe tregtim i skrapit, shkaterim i mjeteve te skrapit, import e eksport brenda dhe jashte vendit.
- Tregti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, industriale, makineri dhe pajisje, transport per vete dhe per te tretet. Import - eksport. Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi tregtimi, sherbimi, do te bashkepunoje me persona fizike e juridike vendas dhe te huaj.

Neni 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1. Kapitali fillestar i shoqërisë është 1.000.000 (nje milion) leke, i ndarë në 1 (nje) pjese nepermjet ortakeve sipas vlerave.

5.2. Kapitali do te depozitohet ne llogarinë e shoqerise ne formim e siper. Kapitali i shoqërisë prej 1.000.000 (nje milion) leke i ndarë eshte nenshkruar plotesisht nga ortaket e shoqerise, ku shuma prej 1.000.000 (nje milion) leke ose 100 % e vlerës se kapitalit themeltar, vleresuar ne 1 pjese, do te depozitohet nga ortaket si me poshte:

- Skënder Çela, zotëron 1 (nje) pjese te kapitalit me vlere prej leke 1.000.000 (nje milion) Lekë, e cila perfaqeson 100 % e vleres se kapitalit themeltar;



"HTS COMPANY" Shpk

Neni 7

Kapital i shoqërisë mund të shtohet dhe të zvogelohet bazuar dhe në përputhje të plote me dispozitat përkatëse që parashikohen nga Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Çdo vendim për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë do të përfshijë në hollësi kushtet dhe afatet e pagesës.

Kapitali mund të shtohet me anë të kontributeve në para dhe kontributeve në natyrë.

Ortakët themelues gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi çdo transferim të propozuar të kuotave në raport me kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen, edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët të rinj bazuar dhe në përputhje të plote me dispozitat përkatëse që parashikohen nga Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj janë si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Administratori.

Administrator i shoqërisë është Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues në Tiranë, i identifikuar me Kartën e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me datë 26.02.2019 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar. Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe të Administratorit janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.


Neni 7

Ortakët dhe punonjësit e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qofte dhe pjesërisht.

Neni 8

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Te punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.



"HTS COMPANY" Shpk

Neni 9

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 10

Ne se shoqëria do te likuidohet atëherë do te caktohet një komision likuidimi qe do te parashtroje një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 11

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet nje ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndrojë ne detyre per aq sa përcaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

Neni 12

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 13

Çdo mosmarrëveshje qe lind ndërmjet ortakut ne lidhje me ketë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo qe nuk kane te bëjnë me Shoqërinë), do te zgjidhet me mirëkuptim dhe do te diskutohet ne mënyre te drejtpërdrejtë ndërmjet palëve te interesuara.


Ne rast se nuk arrihet ne një zgjidhje me mirëkuptim te mosmarrëveshjes, çështja do t'i kaloje për gjykim Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 14

Ky akt themelimi, si konfirmim i vullnetit te ortakeve themelues, nënshkruhet rregullisht prej tyre ne Tiranë, sot më 09.04.2021.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQËRISË: "HTS COMPANY" Shpk

1. SKËNDER ÇELA



“HTS COMPANY” Shpk

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR “HTS COMPANY” Shpk

Ne baze te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, ndryshuar me ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne te nënshkruarit:

1. Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues ne Tiranë, i identifikuar me Karten e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me date 26.02.2019 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me cilesine e “ortakut themelues”

shpallim si me poshtë vijon:

FORMIMI, SELIA KOHËZGJATJA E SHOQERISE

Neni 1

Formohet *Shoqëria e me Përgjegjësi te Kufizuar*, me emrin “HTS COMPANY” Shpk, me ortake themelues:

Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues ne Tiranë, i identifikuar me Karten e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me date 024463069 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me cilesine e “ortakut themelues”

Neni 2

Emri i plote i shoqërisë qe perdoret ne dokumente e saj zyrtare eshte **“HTS COMPANY” Shpk**.
Emertimi tregtar i shoqërisë është: **“HTS COMPANY” Shpk**.

Neni 3

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet ne adresen: Rruga “Tish Dahia”, Kika 2, shkalla nr.3, kati 5, apt.22, Tirane

Adresa e shoqërisë me qellim komunikimin elektronik eshte: **celaskender@gmail.com**


Adresat elektronike te ortakeve do te jene si me poshte:

celaskender@gmail.com

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqërisë mund te transferohet ne nje rajon tjeter brenda territorit te Republikës se Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë apo dhe jashte tij.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj



"HTS COMPANY" Shpk

ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Bisnezit (QKB)

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Neni 5

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë gjate ushtrimit te aktivitetit te saj do te jete:

- Projektim dhe Mbikqyrje-Kolaudim te punimeve te zbatimit, si punime germimi ne toke, ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion, mirembajtje godinash civile, industriale, veshje fasada, rruge, autostrada, hekurudha etj.
- NP- I Punime germimi ne toke. NP-2 Ndertime civile dhe industriale. NP-3 Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. NP-4 Rruge autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale. NP-5 Punime nentokesore, ura e vepra arti. NP-6a Diga te cdo lloj madhesie. NP-6b Diga te vogla (diga me lartesi deri 10 m ose me vellim uji te grumbulluar deri 1 milion m3 ose gjatesi kurore dige deri 500 ml). NP-6c Tunele hidroteknike. NP-7a Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje. NP-7b Vepra naftesjelles-gazsjelles-vajsjelles. NP-8 Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje. NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime. NP-10 Ndertimi i impianteve per prodhimin e energjise elektrike. NP- 11 Ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja e tensionit te larte e te mesem dhe shperndarjen e energjise. NP-12 Punime te inxhinierise se mjedisit.
- NS-1 Punime per prishjen e ndertimeve. NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre. NS-3 Impiante ngritese dhe transportues (ashensore, shkalle, levizese, transportues). NS- 4 Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. NS-5 Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut. NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndricuese. NS-7 Barrierra dhe mbrojtje rrugore. NS-8a Ndertime parafabrikat beton arme. NS-8b Struktura metalike NS-8c Struktura druri. NS-9 Punime strukture speciale. NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale. NS-11 Punime mbi shina dhe traversa. NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit. NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. NS-14 Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. NS-15 Pastrimi i ujerave detare, liqenore dhe lumore. NS-16 Ndertimi i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij. NS- 17 Ndertimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. NS-18 Punime topogjeodezike. NS-19 Sistemet kundra zhurmes per infrastruk-ture. NS-20 Shpime gjeologoinxhinierike, puse e shpime per uje. NS-21 Impiante te trajtimit te ujerave te zeza.
- Kat.1 Projektim Urbanist, Kat.2 Projektim Arkitekt, Kat.3 Projektues Konstruktor Kat.4 Projektues Instalator, Kat.5 Projektues vepra hidraulike Kat.6 Projektues rruge-hekurudha, Kat.7 Projektim ura dhe vepra arti, Kat.8 Projektues gjeodet, Kat 9 Studim gjeologo-inxhinierik-hidrogeologjik, Kat.10 projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike, Kat.11 Projektim te sinjalizimit rrugor, Kat.12 Studime te sizmologjise inxhinierike, Kat.13 Studime e projektme te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta urbane, Kat. 14 Studime e projektme te ndertimit te impianteve te trajtimit te ujerave te zeza.
- Hartim projekti dhe mbikqyrje punimesh per resataurimin e objekteve qe jane monument kulture si dhe Mbikqyrje te mirembajtjes.



“HTS COMPANY” Shpk

- Auditim mjedisor dhe ekspertize ne vleresimin e ndikimit ne mjedis ne te gjitha fushat e ndertimit dhe teknologjite me ndikim ne mjedis. Ndertime turistike, bujqesore, etj dhe kompletim me instalimet e nevojshme.
- Ekspert privat zjarrfikes.
- Konsulence teknike, sherbime, projektim e zbatim, revizion dhe tregtim ne fushat punime topogjeodezike, gjeodezi inxhinierike, hartografi, fotogrametri, rivelime topografike, punime topogjeodezike, sistemet e informacioneve gjeografike. Vlersim Pasurie per Toke dhe Ndertesa. Akte Ekspertimi per Gjykate.
- Punime per gjelberim, mbareshtim pyjesh, kryerjen e sherbimit per sperkatjen me herbicide kunder semundjeve te ndryshme, mbrojtjen e druve frutor nga parazitet dhe mbrojtja e bimesise me metoda biologjike.
- Master plane studime plane rajonale urbanistike, plan rregullus te pergjithshem per qendera te banuara dhe qytete.
- Mbikqyrja dhe kolaudimi i punimeve te ndertimit, etj. grumbullim dhe tregtim i skrapit, shkaterim i mjeteve te skrapit, import e eksport brenda dhe jashte vendit.
- Tregti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, industriale, makineri dhe pajisje, transport per vete dhe per te tretet. Import - eksport. Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi tregtimi, sherbimi, do te bashkepunoje me persona fizike e juridike vendas dhe te huaj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

6.1.Kapitali fillestar i shoqërisë është 1.000.000 (nje milion) leke, e ndarë në 1 (një) pjese nepermjet ortakeve sipas vlerave te percaktuara ne piken 6.2 te ketij statuti.

6.2. Kapitali i shoqërisë prej 1.000.000 (nje milion) leke i ndarë eshte nenshkruar plotesisht, ku shuma prej 1.000.000 (nje milion) leke ose 100 % e vlerës se kapitalit themeltar, vleresuar ne 1 pjese, do te zoterohet nga ortaket si me poshte:

- Skënder Çela, zotëron 1 (nje) pjese te kapitalit me vlere prej leke 1.000.000 (*nje milion*) Lek, e cila perfaqeson 100 % e vleres se kapitalit themeltar;


Neni 7

Kapital i shoqërisë mund te shtohet dhe te zvogelohet bazuar dhe ne perputhje te plote me dispozitat perkatese qe parashikohen nga Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

Çdo vendim për zmadhimin e kapitalit te shoqerise do te perfshije me hollesi kushtet dhe afatet e pageses.

Kapitali mund te shtohet me ane te kontributeve ne para dhe kontributeve ne natyre.

Ortaket themelues gëzojnë te drejtën e parablerjes mbi cdo transferim te propozuar te kuotave ne raport me kuotat qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.



“HTS COMPANY” Shpk

Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen, edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët e rinj bazuar dhe në përputhje të plote me dispozitat përkatëse që parashikohen nga Ligji 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 9

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plote të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 10

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund t’ua tërheqin.

Neni 11

Kuotat e çdo anëtarë të përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtarë i shoqërisë mund t’ua ofrojnë të tjerëve. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të tjerë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Asamblesë së ortakëve duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjti me atë që do t’i ofrohet dhe një personi të tjerë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Asambleja e Ortakëve përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t’ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Asamblesë së Ortakëve.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në proporcion me kuotat që zotëron secili prej ortakëve në këtë shoqëri. Asambleja e Ortakëve pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të tjerë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

Të gjitha transferimet e kuotave kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 12

Emërtimi i shoqërisë tregtare duhet të përmendet në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tjerëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.



“HTS COMPANY” Shpk

Neni 13

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme
- 2- Administratori/et.

ASAMBLEJA E PREGJITHSHME

Neni 14

Organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Ajo mbledhet për të marrë vendimet që i takojnë Asamblese sipas statutit dhe legjislacionit në fuqi.

Asambleja e Ortave vendos me shumicë të thjeshtë të votave të ortave të pranishëm në mbledhje, nëse mbledhet kuorumi i parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare (Shumica e Zakonshme) për çështjet e mëposhtme:


- Përcaktimi i politikave dhe procedurave të veprimtarisë së shoqërisë
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të performancës
- Miratimi i rregullave të brendshme të funksionimit të shoqërisë
- Çështje të tjera të përcaktuara nga legjislacioni
- Emerimi dhe shkarkimi i administratorit/ve
- Emerimi i ekspertit/ve Kontabel të Autorizuar
- Miratimi i shpërblimeve në lidhje me administratorin/ administratorët, ekspertin/et kontabel të autorizuar dhe për çdo organ tjetër drejtues.
- Përfaqësimi i shoqërisë në procedura gjyqësore dhe procedura të tjera kundër administratorit/eve të saj.

Asambleja e Ortave vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortave të pranishëm në mbledhje, nëse mbledhet kuorumi i parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare (Shumica e Cilesuar) për çështjet e mëposhtme të shoqërisë dhe për çdo çështje tjetër që sipas ligjit duhet të miratohet me shumicë të cilesuar:

- Ndryshime të këtij statuti
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të regjistruar
- Përfundimi i veprimtarisë së shoqërisë, ristrukturimi dhe prishja e saj
- Shpërndarja e fitimit vjetor dhe caktimi i rezervave

Asambleja e Ortave do të mbledhet të paktën një herë në vit brenda 6 (gjashtë) muajve të parë të secilit vit kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të vitit të kaluar financiar të Shoqërisë. Asambleja e Ortave duhet të thirret në rastet e parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Asambleja e Ortave si parim thërret nga Administratori/et, por mund të thirret me anë të një kërkesë me shkrim edhe nga Eksperti Kontabel i Autorizuar i shoqërisë, një likuidator i emëruar për të likuiduar shoqërinë, një ose më shumë ortave që kontrollojnë së bashku të paktën 10 % (dhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë ose çdo individ tjetër në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



"HTS COMPANY" Shpk

Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së ortakeve përmban rendin e ditës, datën, orarin dhe vendin e mbledhjes dhe çështje të tjera të përcaktuara në nenet përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe duhet t'u dërgohet ortakeve të paktën 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së parashikuar të mbledhjes me anë të postës me lajmërim marrje, postës korrier, faksit ose postës elektronike.

Kur asambleja e ortakeve nuk është thirrur në përputhje me këtë nen, ajo mund të marrë vendime të vlefshme nëse të gjithë ortaket janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsive në njoftim të asamblese.

Asambleja e ortakeve zhvillohet në selinë e shoqërisë apo në një adresë tjetër që përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e asamblese.

Çdo ortak ka të drejtën për t'u përfaqësuar nga një person tjetër në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Vendimet e asamblese së ortakeve të miratuara në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe këtij Statuti janë detyruese për shoqërinë.

Procesverbal i çdo Asambleje të ortakeve do të mbahet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe do të nënshkruhet nga të gjithë ortaket e pranishëm në mbledhje ose nga një noter publik nëse ky i fundit është njoftuar dhe është i pranishëm në mbledhje. Çdo ortak ka të drejtë për të kërkuar një përmbledhje të saktë të qëndrimit të tij.

Proces verbal i mbledhjes së Asamblese së Ortakeve mbahet nga Administratori ose një nga administratorët. Administratori që mban proces verbalin e asamblese së ortakeve ka të drejtën që të lëshojë një kopje të proces verbalit të lartpërmendur.

Asambleja e Ortakeve mbledhet nga çdo anëtar i shoqërisë që përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë.

Në qoftë se Asambleja është mbledhur sipas rregullave të caktuara ajo mund të marrë vendim kur çdo anëtar i shoqërisë është prezent dhe nuk kundërshton mbledhjen e Asamblesë. Çdo anëtar i shoqërisë ka të drejtë të vere në rendin e ditës problemin që ai dëshiron. Për këtë duhet të informohen anëtarët 3 ditë përpara.

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Neni 15

Asambleja e përgjithshme ka drejtat e mëposhtme:

- Ka të drejtë të beje ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortaket që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka të drejtë të miratojë pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të beje ndarjen e fitimit (pas tatimit dhe rezervave ligjore).
- Ajo emëron administratorët, ekspertin/et kontabël të autorizuar.



“HTS COMPANY” Shpk

- Ajo ka te drejte te beje përjashtimin e një ortakut nga shoqëria për rastet e parashikuara në ligj si dhe në rregulloren e brendshme të shoqërisë.
 - Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë së ortakëve.
 - Përcakton shpërblimin për administratorin/et, ekspertet kontabel të autorizuar.
 - Miraton transferimin e kuotave të ortakëve të tretë.
 - Ben lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata të lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
 - Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë etj.
- Emertimi i shoqërisë mund të ndryshojë vetëm me vendim të ortakëve të saj.

Neni 16

Asambleja e zakonshme mbledhet të paktën 1 herë në vit, brenda 6 muajve nga dita e mbylljes së veprimtarisë vjetore.

Asambleja e përgjithshme thirret kur Administratori/et e shohin të arsyeshme ose kur kërkohet nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast Administratori/et kanë të drejtë të vendosin ditën e mbledhjes jo më larg se 30 ditë nga dita e kërkesës.

Neni 17

Kur pjesëmarrja në asamble është normale vendimet që merren brenda kufijve të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar edhe për ata që nuk janë dakord.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.


Në Asamblenë e Ortakëve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim pa të drejtë vote eksperte, revizore etj.

Neni 18

Asambleja e ortakëve merr vendime të vlefshme në rastet e parashikuara më poshtë:

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 përqind të kuotave. Në rastin kur asambleja e ortakëve duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posaçme. Nëse asambleja e ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit, asambleja e ortakëve mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e ortakëve vendos



“HTS COMPANY” Shpk

me tri te katertat e votave te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj ose statut, per ceshtjet e tjera asamblea e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne ligj ose statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.

Neni 19

Marrja e vendimeve te Asamblesë se ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bëjnë me te duhet te bëhen sipas legjislacionit ne fuqi për këtë qellim.

ADMINISTRIMI

Neni 20

20.1 Shoqeria mund te kete një ose më shumë administratorë. Administratori/et kane te drejte qe te gjitha kompetencat sipas ketij statuti t'i ushtrojnë se bashku apo veç e veç sipas vendimit perkates te Asamblese se Ortakeve duke qene sipas rastit pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë apo te treteve.

20.2 Administratori/et qëndrojnë ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet. Asambleja e ortakeve ka te drejten e zgjatjes apo shkurtimit te ketij afati sipas vendimit te saj, pa qene nevoja qe ky vendim te argumentohet me arsye, dokumente apo cdo lloj tjeter justifikimi.

20.3 Administratori/et kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise dhe per ta perfaqesuar shoqerine ne marredhenje me te tretet me përjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve apo asamblese se ortakeve.

20.4 Fillimisht per nje *afat te papercaktuar* shoqëria do te administrohet nga nje administrator i vetem i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas ratifikohet brenda 30 diteve kalendarike nga Asambleja e Ortakeve. Nese Aambleja e pergjithshme nuk vendos per shtimin e numrit te administratoreve, afati i qendrimit ne kete detyre i administratorit te pare caktohet ne 5 vjet.

20.5 Administrator i shoqërisë është Skënder Çela, i lindur në Tepelenë, më 06.04.1968, banues ne Tiranë, i identifikuar me Karten e identitetit me nr 024463069 dhe nr personal G80406050W, e vlefshme deri me date 26.02.2019 me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Neni 21



"HTS COMPANY" Shpk

21.1 Ne të gjitha kontratat me te tretet, ne te gjithë transaksionet dhe veprimet me te tretet shoqëria perfaqesohet nga administratori i vetem apo nga dy administratore te perbashket nese administratorët e shoqërise jane me shume se nje.

KUFIZIMET E KOMPETENCAVE TE ADMINISTRATORIT/VE:

Neni 22

Ne veprimet bankare, shoqëria perfaqesohet nga Administratori i shoqërise. Ai ka te drejte te delegoje vetem te drejten e depozitimit te fondeve nga arka e kompanise ne llogarine bankare duke e njoftuar kete bankave me shkrese te thjeshte (pa qene nevoja per noterizim). E drejta e terheqjes se fondeve ne cash dhe e drejta e transferimit te fondeve nuk mund te delegohet personave te tjere, nese nje gje e tille nuk behet me vendim te asamblese se ortakeve dhe i behet e ditur bankes me akt noterial. Administratori ka te drejtën e përfaqësimit për transaksione qe nuk kalojnë shumën prej 20.000 (njezete mije) Euro, dhe per cdo veprim pertej kësaj shume administratori do te mund te kryeje veprimet vetëm bazuar ne vendimin e asamblesë se ortakeve me shumice te cilësuar.

Neni 23

Administratoret janë te detyruar te organizojne mbajtjen e librave kontabel, raportimin financiar sipas standardeve ne fuqi dhe kerkesave te autoriteteve tatimore dhe autoriteteve te tjera.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 24

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria merr përsipër te respektojë rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen per demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 25

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane përcaktuar si te tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

EKSPERTET KONTABËL

Neni 26

Auditimi e pasqyrave financiare te shoqërise i besohet nje eksperti kontabël, i cili eshte i detyruar qe pervec opinionit te tij mbi vertetesine eketyre pasqyrave eshte i detyruar të shprehë një opinion për Asamblene e Ortakeve ku të shprehë të gjithë opinionet e tij duke perfshirë edhe opinionin per



“HTS COMPANY” Shpk

Administrimin e Shoqërise.

Eksperti kontabel do të qëndroje në detyrë për atë që sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta

BILANCI DHE FITIMET

Neni 27

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e pasqyrave financiare sipas standardeve të raportimit financiar dhe sipas legjislacionit në fuqi.

Shuma e të ardhurave neto pas pagimit të tatimeve dhe krijimit të fondeve rezerve sipas ligjit apo sipas vendimit përkatës së asamblese së ortakëve shpërndahet si dividend ortakëve të shoqërise.

Neni 28

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes së shoqërisë.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 29

Në rast se shoqëria prishet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e saj nga Regjistrimi Tregtar.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME


Neni 31


Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është parashikuar nga ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të shoqërisë në Tiranë, sot më 09/04/2021.

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË: “HTS COMPANY” Shpk

1. SKËNDER ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER STELA R. DEMNERI
ADRESA NR.5, GJIK KUQALI,
PALL "FERAR", NR.1, NR.13
TEL: 692437001

VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

(AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE)

Nr. repertori: 1198

Tirane më 09/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021051380079335202

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER STELA R. DEMNERI**



V2021051380079335202

DATE 09/04/2021

NR REP 1198

VËRTEIM NËNSHKRIMI

AKT THEMELIMI DHE STATUT

Sot, më datë 09 / 04 / 2021, para meje Notere Stela R. Demneri, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Nr.5, Gjik Kuqali, Pall "Ferar", Nr.1, Nr.13, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Z. Skënder Çela, atësia Tafil, amësia Barxhikë, shtetas Shqiptar, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, me adresë "Ali Visha"; Nd. 69; H. 4; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; Tiranë, lindur më 06/04/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 024463069 dhe nr. personal **G80406050W**.

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje noteres dokumentin

"AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"HTS COMPANY" shpk, bashkëlidhur.

Unë noterja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
STELA R. DEMNERI**

